

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Mbi masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Faza finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Kapitulli VII i Kartës së Kombeve të Bashkuara; Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit të RSH me BE.
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Plani Kombëtar i Integritimit Evropian 2019-2021, Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	Në bazë të Ligjit 146/2014, kjo politikë nuk është objekt i konsultimit publik.
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	14.11. 2018
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	15.11.2018
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2018-MEPJ-01
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Shpresa Peza (Shahaj), Përgjegjëse e Sektorit të së Drejtës Ndërkombëtare dhe Traktateve shpresa.shahaj@mfa.gov.al Natalia Kapllanaj, specialiste në Sektorin e Financës natalia.kapllanaj@mfa.gov.al Gëzim Hysa, specialist në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme gëzim.hysa@mfa.gov.al
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?</i> Shqipëria aktualisht zbaton sanksionet ndërkombëtare të vendosura nga Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (KSOKB) dhe masat shtrënguese të Bashkimit Evropian (BE), të cilat ndiqen në përputhje me angazhimin politik të Shqipërisë që rrjedh nga neni 8 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, e 2006 (MSA). Mungesa e ligjit mbi masat shtrënguese ndërkombëtare krijon vështirësi konkrete në zbatimin e tyre, procedurat e ankimit, implementimin, mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit të masave shtrënguese ndërkombëtare. Gjithashtu mungesa e legjislacionit të brendshëm mbi sanksionet ndërkombëtare është pjesë negative e raporteve të strukturave ndërkombëtare që monitorojnë zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare. Konkretisht Komiteti Moneyval i KiE në raportin e vlerësimit të fundit që bëri për Shqipërinë ka konstatuar si problematikë mungesën e një ligji të brendshëm mbi sanksionet ndërkombëtare.	

Ndërhyrja e qeverisë është e domosdoshme për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, kryesisht për sanksionet financiare të armëve të shkatërrimit në masë, Kjo politikë mbështet objektivat e qeverisë të përcaktuara në Planin Kombëtar të Integritetit Evropian 2019-2021, Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivi kryesor i politikës që propozohet është përcaktimi në mënyrë të detajuar i llojeve të sanksioneve ndërkombëtare, procedurave dhe mekanizmave të vendosjes së këtyre sanksioneve, mekanizmave të zbatimit dhe monitorimit të masave shtrënguese, procedurave dhe mekanizmave të ankimit ndaj sanksioneve.

Kjo politikë synon të kontribuojë në:

- paqen dhe sigurinë rajonale e ndërkombëtare;
- promovimin e respektit për të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut;
- përkrahjen e parimeve demokratike dhe sundimit të ligjit;

Kjo politikë synon gjithashtu:

- të zbatojë detyrimet që burojnë nga anëtarësimi i vendit tonë në organizata ndërkombëtare si dhe, nga dëshira për anëtarësim në organizata ndërkombëtare;
- të sigurojë zbatimin e efektshëm të masave shtrënguese ndërkombëtare me fokus parandalimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, duke ngrirë fondet dhe pasuritë e subjekteve përkatëse si dhe,
- të vendosë sanksione për subjektet që dështojnë t’i binden atyre.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e kësaj politike është marrë në shqyrtim situata aktuale në vend, si dhe përvoja ndërkombëtare, kryesisht e vendeve të rajonit, si Madedoni, Kroaci, Serbi dhe për realizimin e kësaj politike janë marrë në konsideratë këto tre opsione:

Opsioni bazë/status quo - “Zbatimi i drejtpërdrejtë i rezolutave të OKB-së”;

Opsioni 1 – “Ndryshim në ligjin nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”;

Opsioni 2 – “Hartimi i një ligji specifik për masat shtrënguese ndërkombëtare”.

Nga krahasimi i opsioneve të mësipërme për realizimin e politikës që duam, parë në optikën e avantazheve/disavantazheve rezulton:

1. Zbatimi i opsionit bazë, nuk kërkon ndërhyrjen e qeverisë, por do të ndesh vështirësi sa i takon zbatimit në praktikë të masave shtrënguese, në kushtet ku nuk ka procedura ligjore të përcaktuara qartë për t’u ndjekur nga institucionet kompetente. Duke mos pasur një ligj specifik, zbatimi i drejtpërdrejtë bie poshtë, referuar edhe nenit 5 të Kushtetutës. Për më tepër, rezolutat nuk parashikojnë apo përcaktojnë mekanizmin dhe procedurën zbatuese të masave shtrënguese ndërkombëtare, çka e bën të domosdoshëm pasjen e një instrumenti të brendshëm ligjor që ta garantojë një gjë të tillë.
2. Zbatimi i opsionit 1 që konsiston në ndryshimin e ligjit do të sillte si avantazh vetëm përcaktimin e një strukture/mekanizmi për shpalljet e brendshme dhe vetëm për subjekte të cilësuar si financues të terrorizmit. Disavantazhi i këtij opsioni qëndron në faktin se nuk do të mund të adresohet përfshirja e të gjitha llojeve të masave shtrënguese me qëllim ruajtjen e paqes dhe sigurisë, e jo të kufizohemi vetëm në trajtimin e masave që lidhen me terrorizmin.
3. Ndërkohë opsioni 2 që i referohet hartimit të një ligji specifik, do të rregullojë procedurën e vendosjes, zbatimit dhe shfuqizimit të masave shtrënguese ndërkombëtare ku përfshin dhe çështje/fusha të tjera që mbulojnë Rezolutat e

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Me opsionin 2 të preferuar “hartimi i një ligji specifik” synohet krijimi i hapësirës së nevojshme për të arritur objektivin e synuar, duke përfshirë të gjitha parashikimet e duhura dhe të nevojshme për zgjidhjen e problematikës.

Impakti që vjen nga vendosja e masave shtrënguese ndërkombëtare prek ekonominë e vendeve vendosëse dhe atyre të synuara objekt të këtyre sanksioneve nëpërmjet kostove të nevojshme për përshtatjen e ekonomisë vendase në kundërveprim të efektit të këtyre sanksioneve. Në afatgjatë, ekonomia objekt i sanksioneve mund të arrijë të neutralizojë efektin negativ dhe madje edhe të sjellë përfitime nëpërmjet gjetjes dhe zhvillimit të furnizimeve alternative vendase. Në lidhje me subjektet individualisht të përcaktuara ndaj të cilave drejtohen këto sanksione, qofshin këto persona fizik apo entitete të tjera, efektet janë të kufizuara tek këto dhe subjektet e lidhura financiarisht me to. Në rast të ankimit pranë instancave gjyqësore përkatëse nga ana e këtyre subjekteve mund të kemi edhe rast zhdëmtimi nga shteti. Duhet theksuar, se si pasojë e shtresave të shumta të pasigurisë të skenareve të ndryshëm të mundshëm, analiza e këtij impakti kufizohet në një trajtim teorik të mbështetur në literature.

Kostimi mund të realizohet në terma sasior vetëm përse i takon zbatimit të kësaj politike nga institucioni përgjegjës, pra Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. Konkretisht kostot që lidhen me implikimet buxhetore kanë të bëjnë me shtesat në burimet njerëzore në kontekst të krijimit të një strukture që do të merret me koordinimin ndërinstitucional për zbatimin e politikës si dhe regjistrin elektronik si një mjet të realizimit të saj.

Përse i takon impaktit social, për politikën në fjalë kjo lidhet me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore si dhe ruajtjen e sigurisë kombëtare dhe asaj ndërkombëtare, nëpërmjet parandalimit të individëve dhe personave juridikë në kryerjen e veprimeve e mos/veprime në dëm të këtij qëllimi. Kjo politikë, për nga natyra dhe qëllimi i saj, përpos detyrimeve në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare, është e lidhur qënësish me përfitimet e karakterit social që vijnë prej saj. Të prekur janë gjithashtu drejtësia kriminale, policia, agjencitë e sigurisë, lufta kundër pastrimit të parave si dhe rritja e transparencës në Shqipëri.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni 2 (i preferuar) – “Hartimi i një ligji specifik për masat shtrënguese ndërkombëtare”.

Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1 304 000	289 662	276 000

Zgjedhja e opsionit 2 si opsioni i preferuar është bërë për faktin se ky opsion do të mundësojë trajtimin në mënyrë të detajuar të llojeve të sanksioneve ndërkombëtare, procedurave dhe mekanizmave të vendosjes së këtyre sanksioneve, si dhe mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit të masave shtrënguese.

KONSULTIMI

Jepni një përmbljedhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Ky projektligj, nisur nga natyra e tij nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik pasi del jashtë fushës së zbatimit të ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, konkretisht nenit 4, pika b, të këtij ligji, duke qenë se projekt akti i nënshtrohet një procesi vendimmarrjeje që lidhet me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Politika për hartimin e ligjit për vendosjen e masave shtrënguese ndërkombëtare do të zbatohet duke filluar nga viti 2019 dhe për këtë ngarkohen Ministria përgjegjëse për Evropën dhe punët e jashtme si dhe organet e tjera publike sipas fushave të tyre të përgjegjësisë;

Gjithashtu, zbatimi i ligjit do të bëhet nga mekanizmat dhe strukturat përkatëse që do të krijohen për këtë qëllim. Ligji parashikon edhe hartimin e miratimin e akteve nënligjore për të mundësuar zbatimin e tij.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Iniciativa për hartimin e projektligjit për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare vjen në kuadër të:

1. Detyrimit si vend anëtar i Kombeve të Bashkuara për zbatimin e rezolutave të OKB-së që janë në zbatim të Kreut VII (Veprime në rast të rrezikimit të paqes, të prishjes së paqes dhe të kryerjes së një akti agresioni) të Kartës së Kombeve të Bashkuara;
2. Rekomandimeve të Task Forcës për Veprim Financiar (TFVF) që kanë rishikuar standardet ndërkombëtare sa i përket luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Konkretisht, Rekomandimi 6 mbi “Sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e tij” dhe Rekomandimi 7 mbi “Sanksionet specifike financiare të lidhura me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë”.
3. Gjetjeve të Komitetit MONEYVAL (organizëm monitorues i Këshillit të Evropës nën varësinë direkte të Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës), i cili është organizëm monitorues i Këshillit të Evropës nën varësinë direkte të Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës;
4. Gjithashtu, si vend që aspirojmë anëtarësimin në BE, pasja e një projektligji të tillë është kusht dhe në këtë drejtim zbatimi i masave shtrënguese të BE-së është detyrim në vijim të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP).

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Aktualisht, vendi ynë zbaton ato masa shtrënguese ndërkombëtare të ndërmarra në kuadër të Rezolutave të KSOKB-së, natyra e të cilave lidhet me terrorizmin apo financimin e terrorizmit, bazuar në ligjin nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”. Ndërkohë që për masat shtrënguese që nuk lidhen me terrorizmin apo financimin e tij, duke mos pasur një bazë ligjore, institucionet shqiptare hasin vështirësi zbatimi në praktikë. Për rrjedhojë lind nevoja e krijimit të një baze ligjore për zbatimin e tyre.

Nga ana tjetër, ka paqartësi në lidhje me zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të rezolutave të dala në zbatim të Kapitullit VII (Veprime në rast të rrezikimit të paqes, të prishjes së paqes dhe të kryerjes së një akti agresioni) të Kartës së Kombeve të Bashkuara, për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, për shtetet anëtare të saj, duke qenë se natyra e sanksioneve ka ndryshuar që nga themelimi i OKB-së. Për këtë arsye është mjaft e rëndësishme që shtetet të angazhohen për të pasur mekanizma ligjore kombëtare për zbatimin e sanksioneve.

Ndërkohë, procedurat e zbatimit të masave shtrënguese nuk janë të përcaktuara me ligj apo në ligje specifike, gjithashtu edhe procedura e ankimit ndaj masave shtrënguese dhe listimit që mund t'i bëhet një subjekti juridik apo individ për shkak të një mase shtrënguese, duke krijuar kështu një vakum ligjor.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë*

Duke qenë se problemi në shqyrtim është mungesa e një kuadri ligjor që të përcaktojë procedurat dhe mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit të masave shtrënguese, është i pamundur materializimi i tij pa ndërhyrjen e Këshillit të Ministrave, i cili, në përputhje me nenin 81, pika 1 të Kushtetutës ka të drejtën e propozimit të ligjeve. Gjithashtu, duke qenë se zgjidhja e këtij problemi dhe zbatimi më pas i kësaj zgjidhjeje do të bëhet nga institucionet qeveritare dhe jo vetëm, ndërhyrja e ekzekutivit është thelbësore.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrje synohet të:

- Përbushen detyrimet si vend anëtar i Kombeve të Bashkuara për zbatimin e rezolutave të OKB-së që janë në zbatim të Kreut VII (Veprime në rast të rrezikimit të paqes, të prishjes së paqes dhe të kryerjes së një akti agresioni) të Kartës së Kombeve të Bashkuara;
- Zbatohen rekomandimet e Task Forcës për Veprim Financiar (TFVF) që kanë rishikuar standardet ndërkombëtare sa i përket luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Konkretisht, Rekomandimi 6 mbi “Sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e tij” dhe Rekomandimi 7 mbi “Sanksionet specifike financiare të lidhura me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë”; si dhe të Komitetit MONEYVAL (organizëm monitorues i Këshillit të Evropës nën varësinë direkte të Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës), i cili është organizëm monitorues i Këshillit të Evropës nën varësinë direkte të Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës;
- Zbatohen masat shtrënguese të BE-së si detyrim në vijim të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP), në kuadër kjo edhe të aspiratës për anëtarësim në BE.

Qeveria për adresimin e kësaj politike do të ndërhyjë duke propozuar ligjin për vendosjen e masave shtrënguese ndërkombëtare.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë*

Objektivat kryesore të politikës që propozohet janë si më poshtë:

1. Zbatimi i detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi i vendit tonë në organizata ndërkombëtare si dhe, nga dëshira për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.
2. Sigurimi i zbatimit të efektshëm të masave shtrënguese ndërkombëtare me fokus parandalimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë duke ngrirë fondet dhe pasuritë e subjekteve përkatëse si dhe, vendosja e sanksioneve për subjektet që dështojnë t'i binden atyre.
3. Përcaktimi në mënyrë të detajuar i llojeve të sanksioneve ndërkombëtare, procedurave dhe mekanizmave të vendosjes së këtyre sanksioneve, mekanizmave të zbatimit dhe monitorimit të masave shtrënguese, procedurave dhe mekanizmave të ankimimit ndaj sanksioneve, subjekteve ndaj të cilëve do të vendosen masat shtrënguese ndërkombëtare.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura*

Opsioni 0/status quo-së: Zbatimi i drejtpërdrejtë i rezolutave të OKB-së

Sipas nenit 5 të Kushtetutës, Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të. Rezolutat e OKB-së nuk janë të vetëzbatueshme dhe i takon të drejtës së brendshme të çdo shteti të përcaktojë instrumentet përkatëse të zbatimit të tyre.

Opsioni 1: Ndryshim në ligjin nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”,

Ky ligj zbaton vetëm masat shtrënguese ndërkombëtare që lidhen me terrorizmin apo financimin e terrorizmit dhe kufizon zbatimin e sanksioneve për fusha të tjera të cilat prekin paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Opsioni 2: Hartimi i një ligji specifik.

Hartimi i një akti të ri konkret që të parashikojë në mënyrë të strukturuar dhe detajuar procesin e vendosjes së masave shtrënguese ndërkombëtare, me parashikime specifike sa i takon strukturës përgjegjëse që do të propozojë dhe monitorojë zbatimin e këtyre masave, penalitetet që do të aplikohen ndaj subjektit që i është vendosur masa shtrënguese, mekanizmin e ankimimit etj. Hartimi i një akti të tillë do të sigurojë garantimin e një procesi të drejtë, transparent, bazuar në të drejtën ndërkombëtare duke pasur në fokus të drejtat e njeriut.

Opsionet 0 dhe opsioni 1 janë zgjedhur dhe shqyrtuar si opsione të mundshme të zgjidhjes së problematikës, si rezultat i takimeve dhe korrespondencave me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, sa i përket zbatimit të ligjit nr.157/2013, rekomandimeve të TFVF, konkretisht Rekomandimi 6 mbi “Sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e tij” dhe Rekomandimi 7 mbi “Sanksionet specifike financiare të lidhura me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë”, si dhe bazuar në gjetjet e Komitetit MONEYVAL.

Opsioni 2 është zgjedhur duke marrë në konsideratë eksperiencën dhe praktikën e vendeve të cilat kanë një rregullim ligjor të posaçëm në këtë fushë.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Opsioni bazë për zbatimin e drejtpërdrejtë të rezolutave të OKB-së u zgjodh nisur nga parashikimi i nenit 24 të Kreut V të Kartës së Kombeve të Bashkuara që përcakton se, për të siguruar një veprimtari të shpejtë dhe efektive nga Kombet e Bashkuara, anëtarët e tij diskutojnë në Këshillin e Sigurimit përgjegjësinë kryesore për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe bien dakord që me kryerjen e detyrimeve të tyre që rrjedhin nga kjo përgjegjësi, Këshilli i Sigurimit vepron në emër të tyre.

Po kështu neni 25, Kreu V i Kartës parashikon që shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara bien dakord që të pranojnë dhe të zbatojnë vendimet e Këshillit të Sigurimit në përputhje me kartën e OKB-së.

Në zbatim të neneve 48 dhe 49 të Kreut VII të Kartës parashikohet se veprimet e kërkuara për të ekzekutuar vendimet e Këshillit të Sigurimit për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare duhet të merren nga të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara ose prej disa prej tyre siç Këshilli i Sigurimit mund të përcaktojë.

Për këtë arsye u gjykua që rezolutat e OKB-së të ndërmarra në zbatim të kreut VII të Kartës për ruajtjen dhe sigurinë e paqes ndërkombëtare janë të drejtpërdrejtë të zbatueshme për shtetet anëtare të saj, bazuar edhe në nenin 122 të Kushtetutës.

Ndërkohë, sipas nenit 5 të Kushtetutës, Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të. Rezolutat e OKB-së nuk janë të vetëzbatueshme dhe i takon të drejtës së brendshme të çdo shteti të përcaktojë instrumentet përkatëse të zbatimit të tyre. Për më tepër, zbatimi i drejtpërdrejtë i Rezolutave të KSOKB-së nuk mund të shërbejë më si zgjidhje e kësaj situate duke qenë se natyra e vetë sanksioneve ka ndryshuar që nga themelimi i OKB-së, sidomos në kushtet kërcënimesh ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare të shkaktuara nga aktet terroriste janë shtuar shumë vitet e fundit.

Këto faktorë kanë ndikuar në miratimin e Rezolutave specifike të KSOKB-së, si Rezoluta 1267 (1999), Rezoluta 1373 (2001), Rezoluta 1988 (2011) dhe 1989 (2011), Rezoluta 2253 (2015) etj, por edhe në ndryshimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e sigurisë, siç është krijimi i Task Forcës për Veprim Financiar në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Instrumenti ligjor aktual që ekziston për zbatimin e këtyre rezolutave është ligji nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i cili deri në një farë mase përmbush detyrimet ndërkombëtare të vendit tonë. Pra, vetëm sa i takon masave që lidhen me terrorizmin apo financimin e tij.

Në këto kushte, ky opsion është shumë kufizues në vetvete dhe nuk e zgjidh dot problematikën e krijuar. Për më tepër, nuk përmbush objektivin e zbatimit të masave shtrënguese ndërkombëtare në kuadër të BE-së.

Opsioni 1 për ndryshim në ligjin Nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”: Ndryshimi i këtij ligji u gjykua se zgjidhte problematikën nëpërmjet zgjerimit të fushës së zbatimit të ligjit dhe përcaktimit të një procedure ligjore për shpalljet e brendshme si dhe përcaktimin e një mekanizmi që do të kryente shpalljet, si dhe standardizimin e formatit/informacionit që do të përmbajë dosja e shpalljeve kur informohen strukturat përkatëse pranë Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, mbi propozimin për përfshirje të personave në listat përkatëse.

Mirëpo ky ligj zbaton vetëm masat shtrënguese ndërkombëtare që lidhen me terrorizmin apo financimin e terrorizmit, ndërkohë që dalin jashtë fushës së përgjegjësisë së aktit, ato masa që lidhen me parandalimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, sanksionet e vendosura nga KSOKB ndaj Republikës Demokratike të Koresë, ndaj Republikës Islamike të Iranit, sanksionet ndaj Libisë etj, sanksionet autonome të BE-së, madje edhe sanksionet që mund të vendosë vendi ynë ndaj një vendi tjetër.

Opsioni 2 për hartimin/miratimin e një ligji specifik: Në kushtet kur opsionet e sipërcituara nuk zgjidhnin plotësisht çështjet që synon të adresojë akti për zgjidhjen e problematikës dhe përmbushjen e objektivave politike të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, gjithashtu, u vlerësua hartimi/miratimi i një ligji specifik për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare.

Ky opsion është i vetmi që krijon hapësirën e duhur për të arritur objektivin e synuar, atë të përmbushjes së detyrimeve politike të vendit në kuadër të anëtarësimit në OKB, si dhe si vend kandidat për t’u anëtarësuar në BE-së. Arritja e këtij objektiwi realizohet nëpërmjet përcaktimit të procedurave dhe mekanizmave konkret të zbatimit dhe monitorimit të masave shtrënguese duke përfshirë të gjitha parashikimet e duhura dhe të nevojshme në një ligj specifik, si një akt me fuqi normative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Për më tepër, nisur nga eksperiencat e vendeve të rajonit dhe jo vetëm është vënë re që praktika e përdorur për zgjidhjen e kësaj problematike është hartimi i një ligji specifik. Variantet e shqyrtuara janë ato të shteteve si: Kroacia, Serbia, Maqedonia, Kosova, Çekia, Estonia, Letonia etj.

Në kuadër të procesit të vleresimit të ndikimit rregullator për politikën në shqyrtim, për nga natyra e saj detyruese si rrjedhojë e marrëdhënieve ndërkombëtare, vleresimi i opsioneve me qëllim përzgjedhjen ndërmjet tyre, do të kufizohet në analizimin e aspektit ligjor të tyre. Së pari, ndërhyrja me qëllim zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare përbën një detyrim që buron nga marrëveshjet dhe organizatat ndërkombëtare ku ka aderuar shteti ynë, dhe së dyti opsionet në vetvete nuk kanë ndryshime në efektet që sjell secili prej tyre. Konkretisht ndryshimi midis opsioneve ka të bëjë tërësisht me pasjen ose jo të një kuadri të plotë dhe të qartë rregullator, të posaçëm për procesin, dhe konkretisht me përcaktimin e mekanizmave dhe aktoreve që marrin pjesë në ekzekutimin e sanksioneve ndërkombëtare. Kështu, analiza në vazhdim do jetë e tillë që shqyrton impaktin ekonomik, social dhe mjedisor me ndryshime të pakonsiderueshme ndërmjet opsioneve të parashtruara.

Për lehtësi trajtimi, sanksionet ndërkombëtare të synuara pjesë e kësaj politike, do të ndahen në dy grupime në varësi të subjektit ndaj të cilit i drejtohen. Në këtë logjikë, kemi sanksione ndërkombëtare drejtuar shtetit me një numër të konsiderueshëm të prekuri dhe sanksione ndërkombëtare drejtuar subjekteve të veçanta individualisht të përcaktuara (persona fizik apo entitete).

Gjithashtu duhet theksuar, se për shkak të fushëveprimit të gjerë të politikës në fjalë në sanksionet ndërkombëtare që synohen të rregullohen nëpërmjet ndërhyrjes legjislative, skenareve të ndryshëm probabiliteti i të cilave vështirë të përcaktohet, krijohen shtresa të shumta pasigurie çka na detyron të kufizojmë analizen tonë në një trajtim teorik të efekteve të këtyre sanksioneve, kryesisht mbështetur në literature. Për më tepër, në rastin e Shqipërisë janë të pakta rastet e vendosjes së sanksioneve ndërkombëtare, çka nuk mundëson një analizë të mirëfillte të bazuar në të dhëna historike.

Në vazhdim të logjikës së ndarjes së sanksioneve duke përdorur si kriter subjektin të cilit i drejtohen, në lidhje me sanksionet e grupit të parë, duhet theksuar se ndërprerja e marrëdhënieve ekonomike apo kufizimi i tyre, kanë një efekt të konsiderueshëm në ekonominë e vendit “target”, pra vendit ndaj të cilit vendosen këto sanksione. Këto sanksione kanë efekte të ngjashme financiare me format e tjera të ndërhyrjes së qeverisë në tregtinë ndërkombëtare dhe “përfshijnë reduktime të ngjashme në mirëqënien e përgjithshme ekonomike të shtetit “dërgues”¹, atij “target” si dhe në ekonominë globale në tërësi” (Spindler 1995, 206).

Dallimi kryesor ndërmjet sanksioneve ekonomike dhe formave të tjera të ndërhyrjes së qeverisë qëndron në motivin për vendosjen e kufizimit. Shtetet shpesh zgjedhin sanksionet ekonomike si mjete të politikës së jashtme. Duke bllokuar aksesin e vendit “target” në përfitimet e tregtisë së jashtme, shtetet “dërguese” kërkojnë të detyrojnë shtetin “target” në ndryshimin e një lloji politikë me qëllim heqjen e sanksioneve të vendosura. Përveç imponimit të kufizimeve në mallra të veçanta që vendi “target” do të

1. Shteti “dërgues” është shteti i cili vendos sanksionet, ndërsa shteti “target”, ose e thënë ndryshe shteti i synuar, shteti ndaj të cilit vendosen këto sanksione.

preferonte të fitonte nëpërmjet tregtisë, sanksionet gjithashtu mund të kërkojnë të kufizojnë aksesin e tij në tregjet e kapitalit (Biersteker et al., 2016).

Vendet që i nënshtrohen sanksioneve që kufizojnë aksesin e tyre në tregtinë dhe financat ndërkombëtare do të përpiqet të gjejë burime të tjera për mallrat e kufizuara në një përpjekje për të minimizuar efektet e sanksioneve. Masat kundërvepruese specifike përfshijnë zhvillimin e furnizimeve alternativë të mallrave dhe kapitaleve të sanksionuara, si dhe rritjen e nivelit të prodhimit vendas të këtyre mallrave. Të dyja këto masa sjellin kosto afatshkurtra, deri në momentin që shteti “target” arrin të rregulloj ekonominë e vet për të akomoduar sanksionet e vendosura.

Efektet afatgjata të sanksioneve, ose e thënë ndryshe impakti ekonomik jo i drejtpërdrejtë, mund të jenë më pak të rëndësishme nëse shteti “target” është në gjendje të bëjë ndryshimet dhe përshtatjet e nevojshme për të mbijetuar pa mallrat e sanksionuara. Një skenar tjetër ka të bëjë me pamundësinë e shtetit “target” për të gjetur burime alternative për mallrat e sanksionuara që e detyrojnë të bëjë pa to. Në këtë rast, efekti i sanksioneve ka të ngjarë të vazhdojë për një periudhë më të gjatë kohore. Në mënyrë të përmblendhur mund të themi se pasojat konkrete do të varrojnë nga shumë faktorë, duke përmendur si më kryesorët: shteti dërgues-vendosës të sanksioneve, natyrës së sanksioneve, mundësive që ka vendi “target” për të modifikuar ekonominë në varësi të drejtimit që do të marrë ekonomia vendase në industritë e ekonomisë si dhe ndryshimet që do të pesojnë ato si pasojë e sanksioneve ekonomike.

Më tej, për të vazhduar me grupimin e dyte të subjekteve ndaj të cilave drejtohen këto sanksione, pra grupi i individëve dhe entiteteve individualisht të percaktuar, duhet theksuar se bëhet fjalë për një efekt mjaft të kufizuar, të përcaktueshëm në varësi të subjekteve specifike ndaj të cilave i drejtohen këto sanksione. E thënë më thjesht subjektet ndaj të cilave drejtohen këto sanksione janë edhe subjektet e vetme të prekura. Konkretisht, po ti referohemi të dhënave, në dokumentin e njohur si Lista e Konsoliduar e Sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara² rezultojnë vetëm dy sanksione të aplikuara për subjektet shqiptare. Të dyja këto raste kanë të bëjnë me financimin e terrorizimit nga subjektet e sanksionuara dhe kanë pasur si sanksione embargon e armeve dhe ngrirjen e aseteve. Në njëren prej tyre, ku subjekti i prekur është person fizik, është vendosur edhe sanksioni ndërkombëtar i ndalimit të levizjes.³ Rrjedhimisht për shkak të të dhënave historike mjaft të kufizuara si pasojë e rasteve të pakta të ndodhura në Shqipëri por edhe ndryshimeve rast pas rasti, parashikimi i efekteve ekonomike për këtë grup të dytë subjektesh të prekura, nuk sjell vlerë për këtë analizë.

Një rast tjetër që mund të përmendet ka të bëjë me kërkesat shitesë që mund t’i vendosen subjekteve financiare bankare dhe atyre jo-bankare. Këto kërkesa mund të kenë të bëjnë me monitorimin dhe kryerjen e asaj që njihet si “due diligence” ,pra marrjes së hapave të nevojshme për parandalimin e shkeljeve nga klientet e këtyre institucioneve. Zbatimi i tyre mund të shoqërohet me kosto shitesë për subjektet financiare të cilat janë të detyruara ti zbatojnë në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Të tilla mund të përmendim shtimin apo ndryshimin e termave bankare në kontrata, rritjen e monitorimit

2. <https://scsanctions.un.org/fop/fop?xml=htdocs/resources/xml/en/consolidated.xml&xslt=htdocs/resources/xsl/en/consolidated.xsl>

3. <https://www.interpol.int/en/notice/search/un/5896179> - International Criminal Police Organization - INTERPOL

dhe kontrollit nëpërmjet strukturave dhe mekanizmave të reja, si dhe bllokimin e aseteve. Në vazhdim të kësaj logjike, në mënyrë të pashmangshme kemi dhe efektin zinxhir që mund të prekë subjekte të tjera që janë të lidhura financiarisht me subjektet objekt të sanksioneve ndërkombëtare. I tillë është rasti i detyrimeve të palikuiduara që subjektet e sanksionuara kanë ndaj të tretëve, të cilat si pasoje e ngrirjes së aseteve apo sekuestrimit të tyre, vonohen në likuidim apo edhe humbën plotësisht.

Përpos kufizimeve të shumta të kësaj analize, të lidhura kryesisht me përfitimet e rrjedhura, te kostimi është i mundur përcaktimi dhe vlerësimi i disa elementeve të tij, ndonëse jo në mënyrë të plotë. Për të folur me konkretisht për kostot që do të shoqërojnë ndërhyrjen e qeverisë në ekzekutimin e sanksioneve ndërkombëtare, do ndalemi në elementet e paraqitur si mëposhtë.

Elementë shpenzimi	Opsioni 0 ⁴	Opsioni 1	Opsioni 2
1. Hartimi/përpunimi i legjislacionit	✗	✗	✗
2. Ngritja e strukturave të reja/shtim në personel	✗	✓	✓
3. Sistem IT	✗	✓	✓

Tabela 1: Shpenzimet sipas opsioneve në shqyrtim

Sic tregohet në Tabelën Nr. 1, dallimi përsa i përket efektit në kosto, qëndron vetëm midis Opsionit Nr. 0 në raport me dy opsionet e tjera. Opsioni i status quo-s nuk sjell kosto shtesë, ndërsa opsioni Nr. 1 dhe opsioni Nr. 2 prekin të njëjtat zëra shpenzimesh. Duke ritheksuar edhe njëherë, natyrën detyruese të kësaj ndërhyrjeje në përmbushjen më të mirë të detyrimit shtetëror të zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare, do të vazhdohet me shqyrtimin e Opsionit Nr. 1 dhe Nr. 2⁵. Duke qënë se, Opsioni Nr. 1 dhe Nr. 2 në raport me njëri-tjetrin nuk shoqërohen me diferenca në kosto dhe përzgjedhja ndërmjet tyre do të bazohet vetëm në ndryshimet në aspektin ligjor të tyre, analizimi i kostove do të trajtohet për të dy opsionet sëbashku.

Opsioni	Kosto	Përfitime
Opsioni 1 & 2	- në afatgjatë ekonomia vendase mund të plotësoj nevojat e saj pa përdorur eksportin si alternativë furnizimi - shtim stafi MEPJ (52,000 Lek/person të punësuar) - regjister elektronik (1 mln Lek) - Mirëmbajtje sistemi 200.000 leke/vit - zhdemtime të mundshme të subjekteve të sanksionuara që kanë ankimuar	- në afatgjatë ekonomia vendase mund të plotësoj nevojat e saj pa përdorur eksportin si alternativë furnizimi - mbrojtja e të drejtës së ankimimit - rritja e transparencës - siguria kombëtare dhe ndërkombëtare - pakësimi i kriminalitetit

Tabela 2: Kostot dhe përfitimet e rezultuara nga politika

4. Opsioni 0 – status quo nuk sjell asnjë kosto të shtuar, por është vendosur në tabelë për krahasim me opsionet e tjera në shqyrtim.

5. Nëse do të ndiqej logjika e thjeshtë ekonomike do të përzgjidhej opsioni Nr. 0 i cili në raport me opsionet e tjera në shqyrtim nuk sjellin kosto zbatimi.

1. Përpunimi dhe plotësimi i legjislacionit ekzistues si dhe hartimi i një projektligji të posaçëm për politikën në fjalë, realizohet me stafin ekzistues, pjesë e institucioneve përkatëse, nëpërmjet ngritjes së një grupi punë.
2. Në kuadër të politikës në fjalë, parashikohet ngritja e një strukture të përhershme pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme që do të marrë me ndjekjen e procedurës së ekzekutimit të sanksioneve dhe realizimin e raportimeve. Për llogaritjen e kostos të rezultuar nga shtesa në personel, do të referohemi rregullimit të strukturës dhe nivelit të pagave për nëpunësit dhe konkretisht VKM-se Nr. 180 të datës 08.03.2017 për disa ndryshime në vendimin Nr. 881 datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për funksionet drejtuese dhe për strukturën e nivelet e pagave në Ministrinë e Punëve të Jashtme” – të ndryshuar si dhe VKM-se Nr. 187 të datës 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve”, në fushëveprimin e së cilës përfshihen edhe punonjësit e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Me supozimin se personi i punësuar nuk ka vjetërsi në punë, për pozicionin e specialistit, do të marrë për bazë gradën diplomatike më të ulët – atashë, të cilës i takon kategoria e pagës IV-b. Duke supozuar gjithashtu se pozicioni në fjalë do të kërkojë pasjen e diplomave të grupit të parë, shtesës për pozicionin të kategorisë IV-b në vlerën prej 38,000 Lek do të shtohet paga e grupit të parë të diplomave prej 14,000 Lek. Në terma bruto, do të rezultojnë një pagë prej 52,000 Lek për çdo person të punësuar.
3. Një tjetër element që mendohet të mund të bëhet pjesë e planifikimit të kësaj politike, ka të bëjë me mbajtjen e një regjistri elektronik të sanksioneve ndërkombëtare që do të realizohet nëpërmjet një sistemi IT-je. Sistemi mendohet të administrohet nga struktura e re që do të shtohet stafit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Ndërkohë institucionet e tjera përgjegjëse për monitorimin e procesit të ekzekutimit të sanksioneve ndërkombëtare do të kenë akses të kufizuar, në varësi të fushës së përgjegjësisë dhe rolit specifik që do të ketë secila njësi në këtë proces.

Përshkrimi dhe zeri që preket	Element të përcaktueshem	Element të papërcaktuar ⁶
Ngritja e strukturave të reja / Shtesa në personel - paga	Paga për person – specialist atashë me Master Shkencor pa vjetërsi pune : 52,000Lek (terma Bruto)	Nr. personeli
Sistemi IT – shërbime speciale	Program IT + akses nga disa institucione + mirëmbajtje vjetore : 1,000,000Lek + (200.000 leke cdo vite mirembajtje sistemi)	Opsione specifike të programit

Tabela 3: Zeri i shpenzimeve që preket dhe elementët e tij

Përsa i takon kostove jo të drejtpërdrejta duhet të përmendim kostot që vijnë si pasojë e zhdëmtimeve të subjekteve të sanksionuara, të cilat në rrugë gjyqësore kanë fituar të drejtat e tyre të demshpërblimit.

6. Element të papërcaktuar që do të përcaktohen nëpërmjet akteve plotësuese në zbatim të politikës.

Duke pasur një procedurë të mirëpërcaktuar, me aktorë dhe role të qarta, mundësohet transparenca për subjektet e prekura dhe të interesuara, si dhe siguria në kuadër të të drejtave të ankimit, si të drejta themelore të njeriut. Në të njëjtën kohë mund të themi se ekzekutimi me rigorozitet i këtyre sanksioneve mund të inkurajojë shkeljet për të cilat vendosen keto sanksione, duke sjell kështu një ulje të mundshme të krimit dhe kontribuar në rritjen e sigurisë kombëtare dhe asaj ndërkombëtare. Hartimi i një kuadri rregullator të posaçëm për problematikën e sanksioneve ndërkombëtare, lehtëson zbatimin e tij nga të gjithë aktorët dhe subjektet e prekura. Në raport me opsionin Nr. 1 është për t'u theksuar se përpunimi i një legjislacioni të ri duke pasur si shembull ligjin Nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”⁷ sjell një ligj, i cili rregullon sanksionet ndërkombëtare të cilat nuk janë të lidhura me veprimtarite terroriste dhe gjithashtu korrigjon hapësirat dhe problematikat ligjore të ligjit të marrë për reference.

Për vetë natyrën e kësaj politike, nuk kemi impakt mjedisor në asnjë nga opsionet e shqyrtuara.

Impakti	Përfitime	Kosto
Ekonomik	✓	✓
Social	✓	✗
Mjedisor	✗	✗

Tabela 4: Përfitimet dhe kostot për llojet e impakteve të politikës

Politika e zbatimit të sanksioneve detyruese ndërkombëtare, për nga natyra e saj nuk ka ndikime mjedisore.

Ekonomik		Social		Mjedisor	
Përfitime	Kosto	Përfitime	Kosto	Përfitime	Kosto
- në afatgjatë ekonomia vendase mund të plotësojë nevojat e saj pa përdorur eksportit si alternative furnizimi	- në afatshkurtër ekonomia vendase mund “të vuajë” mungesën e mallrave apo shërbimeve të sanksionuara që furnizohen nga eksporti (derisa të bëhen përshtatjet e nevojshme)	- mbrojtja e të drejtës së ankimimit	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
	- shtim stafi MEPJ	- rritja e transparencës			
	- regjister elektronik	- siguria kombëtare dhe ndërkombëtare			
	- zhdemtime të mundshme të subjekteve të sanksionuara që kanë ankimuar	- pakësimi i kriminalitetit			

Tabela 5: Përfitimet dhe kostot sipas natyrës

7. Ligji Nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit” me përpunimin e tij përbën opsionin Nr. 1.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj

Opsioni i preferuar është opsioni 2, i cili i korrespondon hartimit të një ligji specifik. Ky ligj do të krijojë hapësirën e duhur për të arritur objektivin e synuar, duke përfshirë të gjitha parashikimet e duhura dhe të nevojshme për zgjidhjen e problematikës, duke trajtuar në mënyrë konkrete llojet e sanksioneve ndërkombëtare, procedurat dhe mekanizmat e vendosjes së këtyre sanksioneve, mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit të masave shtrënguese, procedurat dhe mekanizmin e ankimimit ndaj sanksioneve, subjektet ndaj të cilëve do të vendosen masat shtrënguese ndërkombëtare etj., gjë të cilën dy opsionet e tjera nuk e mundësojnë.

Hartimi i një ligji specifik është në përputhje me rekomandimet e strukturave monitoruese ndërkombëtare, si dhe me objektivat e qeverisë për të zbatuar politikën e sigurisë së BE-së.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Përgjegjës për zbatimin e opsionit të preferuar, ligjit për vendosjen e masave shtrënguese ndërkombëtare, do të jetë Ministria përgjegjëse për Evropën dhe punët e jashtme si dhe organet e tjera publike sipas fushave të tyre të përgjegjësisë. Vetë ligji parashikon krijimin e një strukture përkatëse që do të merret me monitorimin dhe zbatimin e masave shtrënguese.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- Jepni një përshkrim të përmblendhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.
- Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre

Në këtë fazë, të zhvillimit të VN, nuk mund të planifikojmë dot masat e monitorimit dhe të vlerësimit apo të identifikojmë kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Duhet theksuar se llogaritja e vlerës aktuale neto të opsionit të përzgjedhur nuk sjell vlerë për këtë analizë, dhe konkretisht tabela nuk mund të plotësohet në gjithë komponentet e saj. Siç është përmendur gjatë analizës, nuk është e mundur matja në terma sasior të përfitimeve ndërsa kostot, ndonëse të monetarizuara, mbartin mjaft kufizimi dhe supozime të ngritura. Në përfundim, tabela mbetet e plotësuar pjesërisht, duke mos pasur një vlerë aktuale neto të llogaritur.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1	0.9528	0.907	0.8650	0.8242	0.785	0.7483	0.7130	0.679	0.64737

		35	894	73	71	394	51	55	423	8
Kosto për buxhetin – një herë	1 000 000	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto për buxhetin – në vazhdim (2 punonjës)	104 000	104 000	104 000	104 000	104 000	104 000	104 000	104 000	104 000	104 000
Kosto për buxhetin Mirëmbajtje IT 20 %	200 000	200 000	200 000	200 000	200 000	200 000	200 000	200 000	200 000	200 000
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	1 304 000	304 000	304 000	304 000	304 000	304 000	304 000	304 000	304 000	304 000
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	1 304 000	289 662	276 000	262 982	250 579	238 760	227 499	216 769	206 545	196 803
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total	3 469 597									
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	-3 469 597									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	3 469 597	-	-3 469 597
Opsioni 2	3 469 597	-	-3 469 597

Duke qënë se të dy opsionet kanë kosto dhe VAN të barabartë është zgjedhur opsioni 2 si opsioni i preferuar, i cili i korrespondon hartimit të një ligji specifik, sepse hartimi i një ligji të ri do të krijojë hapësirën e duhur për të arritur objektivin e synuar, duke përfshirë të gjitha parashikimet e duhura dhe të nevojshme për zgjidhjen e problematikës, duke trajtuar në mënyrë konkrete llojet e sanksioneve ndërkombëtare, procedurat dhe mekanizmat e vendosjes së këtyre sanksioneve, mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit të masave shtrënguese, procedurat dhe mekanizmin e ankimimit ndaj sanksioneve, subjektet ndaj të cilëve do të vendosen masat shtrënguese ndërkombëtare etj., gjë të cilën dy opsionet e tjera nuk e mundësojnë.